



**Projekt për ndërhyrjen konservuese-restauruese në pikturën murale dhe në  
pjesët e mbetura të ikonostasit në kishën e Manastirit të Shën Mërisë së  
Spilesë, Saraqinishtë, Lunxhëri - Gjirokastër  
Tiranë 2023**



*Miratohet:*

**Autorë:**

**Gentian Vokopola**  
**Genci Treska**


**Sekretari i KKTKM-së**

**Klestë Qirici**

1  
Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale dhe në pjesët e mbetura të ikonostasit në kishën e Manastirit të Shën Mërisë së Spilesë, Saraqinishtë, Lunxhëri – Gjirokastër  
Autorë: Gentian Vokopola, Genci Treska



## 1. Vendndodhja dhe vështrimi historik i monumentit.



Manastiri i Shën Mërisë së Spilesë ndodhet në rrëzë të malit të Çajupit në mes të fshatrave Qesarat dhe Saraqinisht rrreth 20 km nga qyteti i Gjirokastrës. Manastiri është themeluar në shek. XVI dhe është i ndërtuar në një vend të një bukurie të magjishme (Fig.1). Në ditët e sotme kemi trashëguar në gjendje të mirë vetëm kishën e cila është e vetmja ndërtesë që ende ruhet nga kompleksi i dikurshëm i manastirit (Fig.2). Në një fotografi të vitit 1900 vërejmë madhështinë arkitektonike ku spikasin muret e larta rrithuese të manastirit (Fig.3).

Udhëtar anglez, H. Holland<sup>1</sup> shkroi këtë rreth manastirit:

*" Nga hani unë u ngjita lart në male që për të arritur tek manastiri ndoshta janë rrreth 3000 këmbë lartësi dhe kalova natën aty. Ajo e merr emrin nga shpellat përreth që një pjesë e tyre janë natyrale dhe një pjesë artificiale që mund të shihet në hurn gëlqeror që varet mbi manastir. Një nga këto shpella rrëth 40 këmbë mbi këmbën e shkëmbit, u kthye në kapelë e cila është aksesibël vetëm nga një shkallë e realizuar mbi shkëmb. Këtu është një pranverë e vonuar dhe që quhet në shqip: TRATSI, ku fshatrat përreth shkojnë atje në 1 maj, ditën e Shën Ilias, për të marrë ujë të bekuar".*

Besohej se manastiri i Spilesë, ka qënë një qendër e rëndësishme shëruese<sup>2</sup>, e në një periudhë të tijën, kishte aftësinë për të siguruar asistencë mjekësore. Burime të shkruara na informojnë gjithashtu se manastiri i Spilesë, dikur kishte një bibliotekë të pasur, e cila më pas pati humbur. Mystakidis vëren se ajo përbëhej nga dorëshkrime dhe kopje të vjetra<sup>3</sup>.

Rruja në ngjitje të çon deri tek shkëmbi, i cili bie vertikalish mbi territorin e manastirit. Në këtë faqe shkëmbore ka ka mjaftë shpella një prej të cilave është kapela e Shën Nikollës<sup>4</sup>. Ngjitja aty

<sup>1</sup>Holland H. Sir (1815), *Travels in the Ionian isles, Albania. Thessaly, Macedonia during the years 1812 and 1813*, London.

<sup>2</sup> Giakoumis, K., *The Monasteries...*, Birmingham 2002, fq. 184

<sup>3</sup> Po aty, fq. 240

<sup>4</sup>; Studiuesi G. Giakoumis, duke ju referuar një periodiku të shekullit XIX shkruan: Në mes të shkëmbit, atje ku është ndërtuar edhe manastiri ndodhet një shpellë, e cila banohet nga një numër të madh eremitesh të cilët bejnë jetën e asketeve, duke u lutur për shumë orë gjatë natës dhe duke e vëzhguar atë dhe bëjnë martjen e




bëhet nga një shkallë prej hekuri. Një pjesë e shpellës shkëmbore është mbyllur duke krijuar një mjedis të brendshëm më intim dhe të pa ekspozuar, në brendësi të të cilit është vodosur një ikonostas. Më tej në thelli është e vodosur një kuti me eshtra. Nga kapela, zotërohet një pamje dominante dhe zotëruese e luginës si dhe hapësira ku është ndërtuar manastiri.

Ndërsa F. Pukvil shkruan: ...pranë fshatit Steropolis (Stegopol) duhen parë rrenojet e një qyteti antik, që tani quhet Gjonaksat [Dhoksat?], dhe manastiri i Spilesë, ndërtuar dhe pajisur nga perandori Aleks Komneni<sup>5</sup>.

Manastiri i Spilesë administrohej direkt nga patriku i Kostandinopojës dhe gjëzonte statusin e manastirit stavropigjik<sup>6</sup>.

Besohej se manastiri i Spilesë, ka qënë një qendër e rëndësishme shëruuese<sup>7</sup>, e në një periudhë të tijë, kishte aftësinë për të siguruar asistencë mjekësore. Burime të shkruara na informojnë gjithashtu se manastiri i Spilesë, dikur kishte një bibliotekë të pasur, e cila më pas pati humbur. Mystakidis vëren se ajo përbëhej nga dorëshkrime dhe kopje të vjetra<sup>8</sup>.




---

sakramenteve. Ushqimi i tyre konsiston vetëm në substancë natyrale, si fara, barishtë të egra dhe të hidhura në shije, dhe bukë elbi të zezë. Shih, Giakoumis K., *Veprimtaria..*, K.O.A.SH., 2003, fq. 108

<sup>5</sup> Pouqueville, F., C.H.L. "Voyage de la Grèce", Paris, 1820

<sup>6</sup> Barra V., *Delvina..*, Athina 1966, fq. 236.

<sup>7</sup> Giakoumis, K., *The Monasteries..*, Birmingham 2002, fq. 184

<sup>8</sup> Po aty, fq. 240





**Fig.1**



**Fig.2**



**Fig.3**


4

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale dhe në pjesët e mbeturat të ikonostasit në kishën e Manastirit të Shën Mërisë  
së Spilesë, Saraqinishtë, Lunxhëri – Gjirokastër  
Autorë: Gentian Vokopola, Genci Treska



## 2. Përshkrim arkitektonik dhe tipologjik i monumentit

Kisha është ndërtuar në vitin 1634, në kohën e peshkopimit të zotit Kalist dhe me kontributin e jeromonakëve Konstandin dhe Joasaf. Ajo përbëhet nga naosi, narteksi si dhe hajati i hapur me kollona. Naosi është i tipit në formë kryqi me kupolë, me përmasa të brendshme 7,40x6,20 m. Kompozimi planimetrik, zgjidhja konstruktive dhe formulimi i jashtëm arkitektonik ndryshojnë shumë pak nga ato të kishës që ndodhet në fshat (Saraqinisht), gjë që, duke patur parasysh dhe kohën e njëjtë të ndërtimit, na shtyn të mendojmë se të dy kishat do të janë ndërtuar nga të njëjtët mjeshtra<sup>9</sup>.



Planimetria e kishës së Shën Mërisë së Spilesë. (P. Thomo)

Kollonat e brendshme lidhen ndërmjet tyre dhe me muret perimetrale me harqe në të dy drejtimet duke formuar bërthamën qëndrore katrore, të mbuluar me kupolë mbi tambur dhe katër krahët e kryqit, të mbuluar me qemere cilindrike. Kisha ndriçohet nga dritaret e tamburit dhe ato të hapura në muret verior dhe jugor. Në anën perëndimore naosi lidhet me narteksin, i cili mbulohet nga një qemer gjatësor në pjesën qëndrore, i ngritur mbi dy qemere têrthore, në pjesët anësore<sup>10</sup>. Hyrja bëhet nga ana jugore nëpërmjet një portiku me harkada, dhe është i mbuluar me kupolë. Tamburi që ngrihet në lartësi, është tetëfaqësh dhe ka katër dritare që janë edhe burimi i atij pak ndriçimi që hyn në kishë (Fig.4,5). Muratura e tamburit përfundon me një kornizë të fuqishme, të përbërë nga tri rradhë në formë dhëmbësh sharre. Ndërsa absida është e përbërë nga pesë faqe dhe përmban nikelë vogla në pjesën e vendosur në formë dhëmbësh sharre (Fig.6). Edhe studiuesi Konstandinos Giakoumis citon se studimi i elementëve të arkitekturës tregon se është ndërtuar para vitit 1623

<sup>9</sup> Thomo P, *Kishat..*, K.O.A.SH., Tiranë, fq. 145

<sup>10</sup> Po aty, fq. 145



nga të njëjtët mjeshtër që ndërtuan edhe kishën e Shën Kollit në Saraqinishtë, Lunxhëri<sup>11</sup>. Me sa duket kemi të bëjmë me një grup mjeshtërish të aktivizuar në rajon gjatë viteve 1620-1630<sup>12</sup>.




Fig.4



Fig.5




Fig.6

<sup>11</sup> Giakoumis, G., *Monuments...*, Athina, 1994, fq.110, 112

<sup>12</sup> Giakoumis, K., Identifikimi i objekteve të vjedhura, Pjesa I: Ikonostasi i Spilesë (shek. XVII); *Gazeta shqiptare*, 22 nëntor 2013, fq.18

### 3. Piktura murale

Naosi, sipas mbishkrimit që gjendet mbi porten e hyrjes, mjeshtërisht pikturohet prej Mihalit (që duhet të jetë Mihali i Linotopit) në vitin 1634<sup>13</sup>(Fig.7). Sipas studiuesit K. Giakomis, në shkrimin e tij mbi piktorët nga Linotopi, kjo vlerësohet si puna e fundit e pikturave murale që Mihal Linotopi, nënshkruan në territorin e Shqipërisë<sup>14</sup> (Fig.8,9,10).



Fig.7

<sup>13</sup>Ανηγέρθη κ(αί) ανεστορήθι ώ θιος κ(αί) πάνσεπτος νάος της ηπεραγηας Δεσπινής υμ / όν Θ(εοτό)κού κ(αί) ἀνηπαρθένου Μαρηας κ(αι) ἀρχιερατεβόντων ύπο τού θεοφηλεστάτου έπισκόπου Κύρου / Καλιστου ύ κ(αί) δια σύ(ν)δρομής κόπού τε κ(αί) εξόδου τόν οσιοτάτων εν ηύερομονάχης / Κώνσταντίνου κ(αί) Υασόφου κ(αί) τόν τιμητοτάτον κ(αί) εύγενεστάτον ἀρχόντον...ετεληρό / θη εν μηνι αυγούστο -Γ- ηπο χιρός Μηχαήλ επι ετους Ζ Ρ Μ Β (7142=1634) "U ndërtua dhe u piktura ky tempull hyjnor dhe i gjithënderuar i së mbishenjtës zonjës sonë hyjëlindeses dhe gjithmonë virgjëreshës Mari dhe në kohën e Peshkopatit shumë perëndidashës Peshkopit Zotit Kalist dhe me kontributin, përpjekjet dhe shpenzimet e fortshënuarve ndër jeromonakët Konstandinit dhe Jasafit dhe të shumënderuarve e shumëfisnikëve arkondëve nga Saraqinishtau përfundua në muajin gusht 3, me dorën e Mihalit, në vitin 7142 (=1634), shih Popa, Th., "Mbishkrime...", Tirana 1998, fq. 234 dhe Τσαμπουρας, Θ., ΤΑ ΚΑΛΛΙΤΕΧΝΙΚΑ ΕΡΓΑΣΤΗΡΙΑ ΑΠΟ ΤΗΝ ΠΕΡΙΟΧΗ ΤΟΥ ΓΡΑΜΜΟΥ ΚΑΤΑ ΤΟ 16ο ΚΑΙ 17ο ΑΙΩΝΑ, Ζωγράφοι από το Λινοτόπι, τη Γράμμοστα, τη Ζέρμα και το Μπονυρπούτσικό. ΘΕΣΣΑΛΟΝΙΚΗ 2013, fq. 184

Transkriptimi i mësipërm është marrë nga Giakoumis K., *The monasteries...*, Birmingham, 2002, fq. 238, ku paraqitet më i plotë.

<sup>14</sup> Giakoumis K, *Veprimtaria e piktorëve nga Linotopi, në viset e kishës orthodoxe të Shqipërisë*. 2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri. K.O.A.SH., Tirana 2003, fq. 213





Fig.8




Fig.9



Fig.10

25 vite më vonë, pikturohet edhe narteksi, që sipas citimit të mbishkrimit mbi murin lindor, realizohet në vitin 1658/9<sup>15</sup> (Fig.11). Bazuar në mbishkrimet e gjetura, nuk kemi asnjë dëshmi të cituar apo të nënshkruar që flet për autorësinë e pikturës së narteksit (fig.12,13,14,15,16).



**Fig.11**

Studiuesi K. Giakoumis, në hulumtimin e tij, përmend se kjo është një dorë e pa njohur por që ka ngjashmëri me fazën e dytë të pikturës së Ravenjës<sup>16</sup>. Ndërsa studiuesi grek J. Houliaras shkruan për pikturimin e saj në vitet nga 1658-59 nga Ioannis Skoutaris<sup>17</sup>. Jan Skutari, sikundër e cituar edhe më sipër, është përfaqësuesi më domethënës i atelieve të zones së Kastoriasë, dhe pikërisht i atyre të fshatit Gramos<sup>18</sup>. Piktura e narteksit dallohet për numrin e madh të skenave dhe përsonazheve. Spikasin ngjyrat e gjalla dhe të shumëllojshme. Figurat janë skematike. Më shumë se një artist, duket një artizan të cilit nuk i mungon mjeshteria e realizimit të detajeve dekorative apo të realizimit me korrektësi të teknikave të afreskut.

Tek muri verior i narteksit, dallohet një ndërhyrje e një faze të më vonshme, por që përveç faktit që është e dallueshme nuk mund të thuhet më tepër (Fig.17). Këto ndërhyrje të kujtojnë ato të

<sup>15</sup> Άνεγέρθη, κ(αὶ) ἐνεστορίθη ὁ θίος ἄρτυκας, διά σῆνδορμης, κ(αὶ) ἔξόδου δαπάνης τοῦ ἔνγειναιστάτου ἀρχῶντῶς, κίρου Ιωάννου, ἡγούμενέβοντος κύρου Παρθενήου, ἔτους ΖΡΞ

U ndërtua dhe u pikturua narteksi hyjnor me kontributin dhe shpenzimet e harxhitëm e arkondit fort fisnik zotit Joan, në kohën e igumenisë (kur ishte igumen) së zotit Parthen, viti 7167 (=1658/9). Transkriptimi është kontribut i studiuesit Andi Rëmbeci.

<sup>16</sup> Edhe sipas survejimit dhe studimit tonë, mund ta përforcojmë mendimin e tij, duke parë edhe një lidhje ndërmjet dy katholikonëve: faza e parë Linotopite dhe faza e dytë e shkollës së Skutarit, duke ju referuar edhe studiuesit Huliaras. Për këtë shih: Huliaras, I., *The Work..*, Novi Sad, 2013, fq 67.

<sup>17</sup> Huliaras, I., Po aty, fq 68


<sup>18</sup> Skutari punon fillimisht si nxënës me të atin Dhimitrin dhe më pas më dy djemt e tij Dhimitrin dhe Gjergjin, të cilët punojnë së bashku narteksin e kishës së Manastirit të profet Ilias në Stegopol në vitin 1660 (sipas mbishkrimit) dhe naosin e kishës së Manastirit të Shpërfytyrimit Mingul/Drenovë në 1666 (sipas mbishkrimit).



fillim shekullit XX<sup>19</sup>. Ngjyrat janë të forta dhe të pa përpunuara dhe figurat të pa vizatuara mirë. Ripikturime vërehen edhe në figurën e shën Mërisë (portretin) me Krishtin në krahun e majtë. Është e një cilësie të dobët dhe ndoshta realizuar në teknikën e pikturës në të thatë.



**Fig.12**



**Fig.13**



**Fig.14**



**Fig.15**

<sup>19</sup> Këtë supozim na e konfirmon edhe më tepër një shënim i incizuar në suvanë e integruar pjesë e bordurimit konsolidues, I realizuar me sa duket ne vitin 1920, pas një dëmtimi që ka pësuar figura e shën Mërisë në kupolë “autori” shënon edhe emrin J. Beruke.



Fig.16



Fig.17

11

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale dhe në pjesët e mbetura të ikonostasit në kishën e Manastirit të Shën Mërisë

së Spilesë, Saraqinishtë, Lunxhëri – Gjirokastër

Autorë: Gentian Vokopola, Genci Treska

  
  
REPUBLIKAE SHQIPERIESE  
MINISTRIA - KULTURES DHE  
MONUMENTeve KULTURES  
DITËN 11 - 2011

### **3.1 Gjendja e konservimit**

Piktura murale paraqet një problematikë mjaft komplekse degradimi.

#### **Pelikuli piktorik.**

- *Depozitime jo të qëndrueshme.* E gjithë sipërfaqja e pikturës është e mbuluar nga një shtresë relativisht e konsiderueshme pluhuri e krijuar nga pluhurat në atmosferë.
- *Depozitime të qëndrueshme.* Në të gjithë sipërfaqen e pikturës, pothuaj në të gjitha faqet vërehet floreshencë e kripërave (karbonati i kalçiumit). Më së shumti ato janë prezente në naosin e kishës dhe janë të akumuluara si pasojë e lagështirës në ajër (kondensimit), infiltrimit nga lart dhe kapilaritetit. Depozitim tjetër i qëndrueshëm që haset në sipërfaqen e pikturës është prezenca e nxirjeve si pasojë e tymit të qirinjeve e cila bashkë me prezencën e kripërave krijojnë një moskuptim të programit ikonografik dhe pengon qartësinë e imazhit piktorik në pjesën më të madhe të sipërfaqes së pikturuar.
- *Dekoezioni i pigmenteve (humbja e lidhjes).* Në zona të veçanta të pikturës murale si pasojë e lagështirës në interierin e kishës por dhe humbjes së aftësive lidhëse të karbonatit të kalçiumit shfaqet problemi i shpërbërjes së pigmenteve.
- *Alterimi dhe abrasioni.* Lagështia ka favorizuar dhe stimuluar ndryshime në disa prej pigmenteve duke sjellë në disa zona ndryshim të ngjyrës (alterim kromatik) dhe në disa zona të tjera edhe abrasion të patinës e pelkulit piktorik.
- *Lakunat (mungesa e plotë e pelkulit piktorik).* Në shumë pjesë të pikturës vërehet rënie e pelkulit piktorik duke krijuar lakuna të thellësisë e duke nxjerrë në mjaft raste intonakon.
- *Çarjet.* Si pasojë e lëvizjes së strukturës të ndërtesës kryesisht në pjesën e apsidës vërehen edhe çarje të konsiderueshme. Disa krisje të holla vërehen dhe në disa zona të tjera.
- *Humbja e aderencës (ngjitjes).* Ky degradim ndodh për arsyet e mos kryerjes së procesit të karbonatizimit në disa zona por dhe të lagështirës dhe prekjeve seko (në të thatë) duke bërë që pelkuli piktorik të shkëputet nga shtresa preqatitore.
- *Dëmtime mekanike.* Natyrisht nuk mund të mungonin edhe gërvishtjet e emrave të ndryshëm në sipërfaqen e pikturuar ashtu siç ndodh rëndom pothuaj në të gjitha objektet e kultit të krishterë.

#### **Suporti**


- *Humbja e aderencës (ngjitjes).* Një nga problematikat më evidente në pikturën murale të kësaj kishe është humbja e lidhjes së shtresave me njëra – tjetrën (intonako me arricion dhe arricio me murin) duke krijuar shumë xhepa e boshllëqe të cilat rrezikojnë shkëputjen dhe rënien e pikturës shumë më evidente në narteksin e kishës. Kjo problematikë është e përhapur në gjithë sipërfaqen e pikturës murale.



- *Mungesa të pjesshme të afreskut.* Këto mungesa evidentohen shumë në pjesën e narteksit por edhe në naos janë të pranishme.
- *Humbja e kohezionit (lidhjes) dhe abrazion i shtratit pregaritor (intonakos)* si pasojë e prezencës së lageshtisë në interierin e kishës dhe humbjes së aftësive lidhëse të gëlqeres problematikë që vërehet në disa zona të veçanta.

Të gjithë problematikën në gjendjen e konservimit të piktureve murale po e ilustrojmë dhe me fotot që paraqesim në vazhdim.








15

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturen murale dhe në pjesët e mbeturat të ikonostasit në kishën e Manastirit të Shën Mërisë

së Spilesë, Saraqinishë, Lunxhëri – Gjirokastër

Autorë: Gentian Vokopola, Genci Treska







16

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale dhe në pjesët e mbetura të ikonostasit në kishën e Manastirit te Shën Mërisë së Spilesë, Saraqinishtë, Lunxhëri – Gjirokastër

Autorë: Gentian Vokopola, Genci Treska







### **3.2 Ndërhyrjet që do të kryhen për konservimin dhe restaurimin e pikturës murale dhe metodologja që do të përdoret**

- *Depozitimet e paqëndrueshme (pluhurat)* do të pastrohen me kujdes me anë të tamponcinave të pambukut me ujë të distiluar, Ethanol dhe Açeton.
- *Humbja e lidhjes* tek pigmentet do të rikuperohet duke aplikuar direkt në afresk me penel Hidrosidio di barrio ose Fluoline HY në 3% në aceton.
- *Depozitimet e qëndrueshme (nxirjet, kripërat)* do të pastrohen me Bikarbonat ose Karbonat amoni 10% - 20% (sipas rastit) të tretur në ujë me anë të kompresave me arboçel ose në Nevek e më pas duke kryer një shpërlarje të bollshme me ujë të distiluar e në fund duke thithur kripërat e aktivizuara në sipërfaqe me aplikimin sipër pikturës të letrave japoneze. Ndërsa mbivëniet do të pastrohen me anë të bisturive.
- *Humbja e aderences (lidhjes)* të pelikultit piktorik me intonakon. Kjo problematikë do të stabilizohet me përdorimin e Akril 33 2,5% të holluar në H<sub>2</sub>O e Ethanol duke e injektuar me shiringë dhe me aplikim sipër me kartën Melinex.



- *Humbja e aderences (lidhjes)* të intonakos me suportin do të stabilizohet me përdorimin e Ledan TB1 ose PLM ose Akril 33 (sipas rastit) me anë të injektimit me shiringa pasi të jetë kryer më parë hapja e rrugëve me H<sub>2</sub>O dhe Ethanol si veikolant.
- Të gjitha lakunat e bardha që shqetësojnë imazhin e pelikulit piktorik do të trajtohen me integrim piktorik me ngjyra me bazë uji (akuarel) duke kryer kështu unifikimin artistik dhe estetik të të gjithë pikturës.

#### **4. Ikonostasi**

Kisha e Spilesë, ka një ikonostas të gdhendur në dru por që sot paraqitet i cunguar dhe vetëm me pak pjesë origjinale për shkak të vjedhjeve të vazhdueshme që ka pësuar. Sipas studiues Fatbardha Shkupi, dera e bukur e ikonostasit<sup>20</sup> i përket vitit 1660. Ndërsa studiuesi K. Giakumis argumenton dhe analizon një sërë ngjashmërisht në element të ndryshëm të pikturës si dhe duke u nisur prej datës së njërsë prej ikonave të mëdha të ikonostasit vitin 1623, propozon atribuimin e ikonostasit, atelies Linotopite<sup>21</sup>. Studiuesi Mustafa Arapi në artikullin e tij ku analizon veprën e Qipriotit<sup>22</sup>, sinjalizon për praninë e këtij të fundit, si autor i njërsë prej ikonave të mëdha të ikonostasit në kishën e Shën Mërisë së Spilesë. Ikona nuk ka datë as emër, por ngjashmëri stilistike dhe artistike me një sërë ikonash me të njëjtin subjekt “Krishti Pantokrator” të realizuara prej Onufër Qipriotit.

Si rrjedhojë dalim në përfundimin se aktiviteti artistik i kishës së manastirit të Spilesë, ndahet në tre fazë kryesore dhe të dokumentuara. E para lidhet me ikonat dhe ikonostasin që i atribuohen shkollës Linotope, e dyta që lidhet me fazën e parë të pikturimit të naosit dhe vitin 1643, dhe e treta që i përket vitit 1658-9, të atelieve të Gramozit. Në kapelën e shën Nikollës në shkëmbin pranë, është gjetur një ikonë me mbulesë argjendi që paraqet figurën e Shën Mërisë. Në mbishkrimin e saj, mësojmë emrin e një tjetër piktori që për nga mbiemri, duket të ketë të njëjtën prejardhje<sup>23</sup>.

<sup>20</sup> Shkupi, F., Mjeshtër shqiptarë dekoratorë që kanë punuar në Bullgari, Maqedoni dhe Shqipëri, *Monumentet*, Tiranë, 2002. fq 74

<sup>21</sup> Giakoumis, K., Identifikimi i objekteve të vjedhura, Pjesa I: Ikonostasi i Spilesë (shek. XVII); *Gazeta shqiptare*, 22 nëntor 2013; shih po ashtu artikullin e Siulis, T., Ikonostaset e gdhendura në dru në kishat dhe kishëzat e krahanave jugore të kishës orthodhokse të Shqipërisë; *2000 vjet art dhe kulturë kishtare në Shqipëri*, Tiranë 2003, fq. 303-318

<sup>22</sup> Arapi, M., Onufër Qiprioti-ikonograf i shekullit XVI-XVII, *Monumentet*, Tiranë, 2004. Fq.111

<sup>23</sup> Η παρουσα ἀγια τηνα Σπηλεοτις(σ)α εβρησκομενη σηνδρομη τε πατερες ηγουμενεβουντας / Ναθαναηλ κε Γλαυκοιος κε Κοσταντηνος η τημη(οι) αρχοντες ασηνδρομησαν την γοχε / ριαν (=χορηγιαν) Κηρ Κοτζο κε Κηρ Κηριτζυ Σηκριατινη επι χηρος Θεοδορου Ληνοτοπητη 1765 ηουλη 10. “Kjo ikonë e shenjtë Spileotisa që gjendet në Spile është bërë me kontributin e etërve, igumenë, Nathanailit dhe Grigorit dhe Kostandinit, të arkondëve të nderuar, zoti Koço dhe zoti Qirici Sikriatas. Me dorën e Theodhor Linotopasit, 1765, korrik 10



#### **4.1 Gjendja e konservimit**

Ikonostasi është i gdhendur me dru are, me një gdhendje kryesisht me motive floreale e cila është realizuar jo shumë e thellë. Përmasat e ikonostasit janë 610 cm x 299 cm dhe ai është i gruntuar e i piktuar. Ikonat e mëdha dhe kolonat qëndrojne sipër ketabeve të poshtme të ikonostasit ndërsa sipër tyre vazhdon një frizë e kompozuar (epistili) me pjesë të gdhendura në formë guaske që ndahen nga njëra tjetra me figurat e pikturuara me trup të plotë të profetëve: Isaia, Abakumi, Danieli, Moisiu, Davidi, Solomoni, Jezekieli dhe Jeremia. Kjo frizë është mjaft e gjërë rrith 50 cm ndërsa sipër saj është një rrjesht me ikona të vogla të cilat mungojnë të gjitha. Këto ikona lart janë të kufizuara me një frizë më të ngushtë rrith 22 cm e cila dhe ajo është e gdhendur me motivin e guaskës por natyrisht me guaska më të vogla. Epistili, ikonat e mëdha dhe ikonat e vogla me shenjtorë të rreshtit të sipërm ndodhen në Muzeun Historik Kombëtar të zbuluar në vitin 2013, ndërsa një pjesë e frizës më të ngushtë ndodhet ende në kishë dhe e çmontuar nga suporti. Në tëresinë e ikonostasit veç mungesave të mësipërme mungojnë edhe Dyert e Bukura të cilat ndodhen edhe ato të ekspozuara në Muzeun Historik Kombëtar. (Shih fotot dhe dokumentacionin grafik) Materiali i drurit është mjaft i dëmtuar si rrjedhojë e prezencës së madhe të lagështisë kryesisht në pjesën fundore, depozitime të paqëndrueshme dhe të qëndrueshme (një shtresë verniku i dekompozuar) si dhe dëmtim i materialit të drurit nga insektet ksilofage.

Në ambientet e brendshme të kishës së Manastirit të Shën Mërisë së Spilesë në Saraqinishtë gjendet edhe një objekt tjetër me dru të gdhendur me motive floreale i cili ndodhet në pjesën veriore (protezisit) të shenjtërores në vendin e tavolinës prebatitore. Problematika që shfaqet është me të njëjtat problematika si dhe ikonostasi, me depozitime të qëndrueshme dhe të paqëndrueshme, prani të insekteve ksilofage etj.





Ikonostasi në vitin 1997 në gjendjen para vjedhjes së epistilit (ikonat të vjedhura më herët)  
Foto nga Dr. Konstantinos Giakoumis



Ikonostasi në ditët e sotme me mungesa të elementeve

21

Ndërryra konservuese-restauruese në pikturën murale dhe në pjesët e mbeturë të ikonostasit në kishën e Manastirit të Shën Mërisë

së Spilesë, Sarajinishtë, Lunxhëri – Gjirokastër

Autorë: Gentian Vokopola, Genci Treska






22

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale dhe në pjesët e mbeturat e ikonostasit në kishën e Manastirit të Shën Mërisë

së Spilesë, Saraqinishtë, Lunxhëri – Gjirokastër

Autorë: Gentian Vokopola, Genci Treska





**Skica grafike e ikonostasit**




**Epistili në Muzeun Historik Kombëtar**

23

Ndërhyrja konservuese-restauruese në pikturën murale dhe në pjesët e mbeturat të ikonostasit në kishën e Manastirit të Shën Mërisë  
së Spilesë, Saraqinishtë, Lunxhëri – Gjirokastër  
Autorë: Gentian Vokopola, Genci Treska





Dyert e Bukura të ekspozuara në MHK



Pjesë e frizës që ndodhet në kishë

#### **4.2 Punimet që do të kryhen për restaurimin e ikonostasit dhe objekteve të tjera të drurit të gdhendur ose dekoruar.**

- Në fillim do të kryhet pastrimi në të thatë nga mbetjet e insekteve dhe të pluhurave të depozituara në kohë (mbetje të paqëndrueshme). Ky pastrim do të kryhet në mënyrë manuale, në të thatë me anë të furçeve dhe aspiratorëve.
- Disinfektimi do të realizohet në tërë sipërfaqen e drurit me solucion me bazë Permetrine, Perxil-10. Ky solucion ka toxicitet të ulët dhe është transparent (pa ngjyrë) dhe siguron penetrimin e tij në tërë thellësinë e strukturën e drurit. Ky proces do të kryhet manualisht me lyerje me furçë dhe me metodën e injektimit me shiringë.

- Konsolidimi i shtratit piktural me suportin e drurit aty ku do të jetë e nevojshme do të kryhet me xhelatinë (ngjitës lepuri) me letër japoneze në raportin 1 : 13.
- Do të kryhet konsolidimi (petrifikimi i strukturës së drurit) duke përdorur Paraloid B72 të tretur në acetona në masën 3- 4%. Ky rapport është i ndryshueshmë sipas rastit (gjëndjes së drurit). Ky ~~raport~~ duhet të lejojë frysma marrjen e drurit si dhe konsolidimin e tij nga anën strukturore.
- Pastrimi i sipërfaqes së ikonostasit do të kryhet duke përdorur një përzierje Aceton, Alkol etilik dhe H<sub>2</sub>O në rapport të ndryshueshmë sipas problematikës.
- Integrimi (plotësimi) i pjesëve që mungojnë do të kryhet me të njëjtën material druri (druri arre) duke ruajtur formën dhe karakterin e originalitetit. Në pjesët e vogla të dëmtuara kryesisht në pjesën fundore të ikonostasit plotësimi do të kryhet me stuko Araldite SV427.
- Pjesët origjinale të ikonostasit që gjenden në ambientet e kishës propozojmë që të inkorporohen në ikonostas, ndërsa Dyert e Bukura, epistili dhe ikonat e rreshit të sipërm që gjenden në ambientet e MHK të vazhdojnë të qëndrojnë në këto ambiente.

